



KONTRATE PER BLERJE AKSIONESH

Sot me daten 19.07.2006 (dymije e gjashte), ditën e Martorit Dhomen e Noterise Tirane para meje Noteres Publike Eriketa KOKOLI, ndermjet:

- a) **Z. Alfred Gjata**, i biri i Robertit, lindur me 18.04.1961 ne Tirane, dhe banues po aty ne Rrugen "Mujo Ulqinaku", Pall. 44, Ap. 15, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. 0041088, (ne vazhdim i quajtur "Shitesi").
- b) **Z. Vasil Naçi**, i biri i Spiros, lindur me 01.09.1969 ne Gjirokaster, dhe banues ne Tirane, Bul. "Deshmoret e Kombit", Q.N.K, Kati 2^{te}, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. 0012605, (ne vazhdim i quajtur "Bleresi").

Eshte rene dakort sa me poshte vijon:

1. **Shitesi** ka te drejten e plote dhe ekskluzive te pronesise e posedimit te dyqind e nentehjete e nje (291) aksioneve te regjistruara me nje vlere nominale prej njeqind mije (100.000) LEKE secili. Keto aksione perfaqesojne 2,078 % te kapitalit te aksionereve te shoqerise anonime "BANKA POPULLORE" Sh.a, shoqeri qe eshte themeluar dhe qe vepron sipas Legjislacionit Shqiptar, me Vendimin e Gjykares se Shkalles se Pare Tirane Nr. 30724 date 12.12.2003 dhe ne baze te Licenses se Veprimit Nr. 17, date 16.02.2004 leshuar nga Banka e Shqiperise.
2. **Shitesi** i shet, transferon e dorezon pronesine dhe posedimin e plote te te gjitha aksioneve te siperpermendura, dhe me sakte te dyqind e nentehjete e nje (291) aksioneve te regjistruara me nje vlere nominale prej njeqind mije (100.000) LEKE secili, qe perfaqesojne 2,078 % te kapitalit aksioner te shoqerise anonime "BANKA POPULLORE" Sh.a., me te gjitha te drejtat qe rrjedhin prej tyre, **Bleresit** i cili e pranon kete blerje kundrejt çmimit njezete e nente milione e njeqind mije (29.100.000) LEKE. Ky çmim i korrespondon vleres nominale te aksioneve qe blihen. Palet kontraktuese do te proçedojne njekohesisht ne regjistrimin e duhur te ketij transaksioni si ne Librin e Aksioneve, ashtu dhe ne Librin e Aksionereve te "BANKES POPULLORE" Sh.a.
3. **Bleresi** ia ka paguar plotesisht **Shitesit** çmimin prej njezete e nente milione e njeqind mije (29.100.000) LEKE.
4. **Shitesi** deklaron se aksionet transferohen te lira dhe te pastra nga çdo peng, barre ose detyrim tjeter ligjor, ose ndonje difekt aktual ose ligjor ne pergjithesi.
5. Palet bien dakort qe **Shitesi** nuk ka asnje te drejte tjeter ndaj **Bleresit** ne lidhje me blerjen e ketyre aksioneve.

6. Pas transferimit te aksioneve, **Shitesi** nuk ka asnje te drejte ose titull mbi keto aksione dhe **Bleresi** te cilit i jane transferuar dhe dorezuar aksionet ne kushtet e pronesise dhe posedimit te plote, ka te drejte ti zoteroje, posedoje, perdore, shfrytezoje dhe rregulloje ato sipas vullnetit te tij te lire si pronar dhe posedues i tyre. **Bleresi** ka te drejte te ushtroje te tera te drejtat qe rrjedhin nga e drejta e tij e pronesise dhe ai do te marre nga "BANKA POPULLORE" Sh.a. çertifikatat perfundimtare te aksioneve kur ato te leshohen.
7. Çdo mosmarreveshje qe do te linde ne lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kesaj kontrate do te shqyrtohet nga Gjykata kompetente e Tiranes.
8. Palet kontraktuese deklarojne se heqin dore nga e drejta per ta apeluar dhe per ta revokuar (shfuqizuar) kete kontrate.

Ne deshmi te sa me siper, kjo kontrate hartohet ne tre origjinale, nga te cilat nga nje kopje u jepet paleve dhe kopja e trete mbahet nga Noteri Publik, dhe konform vullnetit te lire te paleve, te cilet pasi e lexuan e me ze te larte dhe mbasi u kuptua nga Palet u nenshkrua rregullisht prej tyre para Noterit.

PALET KONTRAKTUESE

SHITESI

ALFRED STAZ

[Signature]

BLERESI

Vasil Nast

[Signature]



NOTERI

[Signature]

[Signature]